



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2020:095589

Datë: 06.06.2024

Numri i dokumentit: 05792318

C.nr.352/20

GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari Robert Tunaj, me sek. juridike F. Kabashi, në çështjen juridike të paditësit KEDS-Distrikti në P, të cilin e përfaqëson i autorizuari V. C, kundër të paditurit B. Sh. S nga Sh, të cilin e përfaqëson i autorizuari av. L. B, me padi për kompensimin e dëmit material, në seancën e mbajtur në praninë e të autorizuarve të paditësit dhe të paditurit, me datë 03.06.2024, mori , ndërsa me datën 06.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit KEDS-Distrikti në P, në të cilën ka kërkuar: “ Të aprovet padia dhe kërkesëpadia e paditësit K. K për D dhe F, me Energji Elektrike Sh.A, dhe të detyrohet i padituri të paguaj dëmin e shkaktuar material në shumë 2350.81 €, me kamat ligjore nga dita e ushtrimit të padis deri në pagesën definitive dhe të obligohet me shpenzimet e procedurës” .

II. Obligohet paditësi që të paditurit ti paguaj shpenzimet e procedurës në shumë 239€ në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësi KEDS-Distrikti në P, pranë kësaj Gjykate ka parashtruar padi për kompensimin e dëmit material, ndaj të paditurit B. S nga Sh.

I autorizuari i paditësit V. C, në seancë ka deklaruar se duke theksuar faktin se i padituri i ka shkaktuar dem KEDS ne vlerën prej 2350 , 81 € dhe bazë për këtë është raporti i kontrollit detal te njësorit të energjisë elektrike me nr. 47/16 i dt. 16.03.2015 se bashku me foto dokumentacionin e bashkangjitur me këtë procesverbal, si dhe Aktgjykimit penal P.nr. 584/15 i dt. 23.09.2016 ku në arsyetimin e tij theksohet se ne bazë të kontratës mbi qiranë te lidhur ne mes te M. B, dhe këtu te paditurit B. S, rezulton qe i njëjti është shfrytëzues i njësorit elektrik i cili është keqpërdore. Sa i për këtë lartësisë së dëmit i njëjti vërtetohet nga fatura DPZ15HP09226 e dt. 19.03.2015 kalkulim ky i cili është bërë me përputhje me procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit te pa autorizuar te energjisë elektrike. Mbi këtë bazë i propozojmë gjykatës qe padinë dhe kërkesëpadinë ta miratoi ne tersi si te bazuar e po ashtu i kërkojmë edhe shpenzimet procedurës në emër te taksës për padi 30 €.

I autorizuari i të paditurit av. L. B, në seancë ka deklaruar se pas pranimit të autorizimit nga pala e paditur dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ku pala e paditur në afat ligjor ka parashtruar edhe përgjigje në padi, ku nga ana e kësaj përgjigje vlen të shtojmë faktin se ky borxh i kërkuar - kompensim demi nga ana e paditëses është parashtruar për faktin se kemi të bëjmë me një padi të ngritur në bazë të Aktgjykimit penal me nr. P.nr. 584/15 të dt. 23 Shtator 2016 me çka borxhi në fjalë i pretenduar nga ana e paditëses tani më është përfshi me parashkrim, me çka kërkojmë nga gjykata që padinë e parashtruar nga ana e paditëses të refuzoi për shkak të parashkrimit. Ka shtuar që në bazë të provave të dorëzuara nga ana e paditëses rezultoi që të paditurit i mungon edhe legjitimiteti i palës pasive në procedurë pasi që Aktgjykimi refuzues P.nr. 584/15 të dt. 23.09.2016 i plotfuqishëm me dt. 17.10.2016 është ndaj të akuzuarit Z. B, ndërsa kjo padi është ngritur në bazë të këtij aktgjykimit vetëm bazuar në arsyetimin e aktgjykimit të lartë cekur, ndërsa procedure penale ndaj të paditurit nuk ka pasur as nuk ka.

Një herët ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë për përgjigje në padi shumen 104 €, dhe për një seancë shumen 135 € në total 239 €.

Gjykata në kuptim të nenit **7 dhe 8 të LPK-së** bëri administrimin e provave dhe atë: ka bërë shikimin në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në S, P.nr.584/15 të datës 23.09.2016, fatura me numër DPZ9033335 i datës 19.03.2015, procesverbalet me nr. 0294095 të dt. 25.02.2015, nr. 0176428 të dt. 25.02.2015, 02/2741 të dt. 17.03.2015, foto dokumentacioni.

Gjykata në shqyrtimin kryesor, pas vlerësimit të provave materiale, deklarimeve të autorizuarve të paditësit dhe të paditurit dhe administrimit të provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar dhe vlerësuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Nga shikimi në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në S P.nr.584/15 të datës 23.09.2016, gjykata ka provuar faktin se ndaj të akuzuarit Z. B, është refuzuar akuza, në mungesë të provave për çka edhe PSh është tërhequr nga akuza. Ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me datën 17.10.2016, dhe në këtë aktgjykim e dëmtuara KEDS Distrikti në P, për realizimin e kërkesës pasuroro -juridike për dëmin është udhëzuar në kontest të rregullt civil. Duke analizuar këtë aktgjykim është provuar në mënyrë të plotë kundërshtimi i të paditurit se kërkesa e paditësit është përfshirë me parashkrim dhe si të till gjykata e aprovon në tersi, pasi me nenin 357 të LMD-së par.1 është përcaktuar se “Kërkesat për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhen për tri (3) vite nga dita kur i dëmtuari ka marrë në dijeni për dëmin dhe për personin i cili e ka shkaktuar dëmin”. Aktgjykimi është nxerr me datën 23.09.2016, i plotëfuqishëm me datën 17.10.2016, ndërsa padia është ushtruar me datën 11.08.2020 pra 3 vite e 9 muaj dhe 24 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Po ashtu me nenin 357 par.2 “Në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për pesë vite nga shkaktimi i dëmit” e që në rastin konkret kanë kaluar të dy afat nga ky nen ngase dëmi është shkaktuar me datën 25.02.2015 ndërsa padia është dozuar në këtë gjykatë me datën 11.08.2020, 5 vite e tetë muaj dhe 25 ditë nga momenti i shkaktimit të dëmit.

Gjykata vendosi që të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar edhe për faktin se paditësi me provat ekzistuese nuk ka mundur ta bind gjykatën se i njëjti ka të drejtën për kompensim të dëmit material të evidentuar si në faturën me numër DPZ15HP09226 te datës 19.03.2015, pasi me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se shkaktar i dëmit ka qenë paditësi, në kuptim të nenit 136 par. 1 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, citoj “ *Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensoi përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Ndërsa me nenin 140 të LMD, është përcaktuar “*fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia*”. Në këtë rast me asnjë provë nuk është vërtetuar fajësia e të paditurit, andaj edhe në mungesë të vërtetimit të bazës - fajit gjykata e refuzon edhe lartësinë e kërkuar të kërkesëpadisë, duke refuzuar kërkesëpadinë në tërësi si të tillë.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe provat dhe theksimet e tjera të palëve ndërgjygjëse, por ka gjetur se të njëjta janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës gjykata e mori konform nenit 452 par.1 të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në kuptim të nenit 143.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË
C.nr.352/2020 data 06.06.2024

GJYQTARI,
Robert Tunaj

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.